



Vizitoni **Bashkinë Selenicë**

Mirë se vini në **Bashkinë Selenicë**, aty ku historia, kultura, traditat dhe zakonet ndërthuren më së miri me njëra tjetrën duke na lënë neve dhe brezave në vazhdim një trashëgimi tejet të çmuar.

Janë të shumta vëndet arkeologjike dhe monumentet kulturore që na ofron zona e **Bashkisë Selenicë**. Ndër to mund të vizitoni rrënojat e qytetit të lashtë Ilir të “**Amantias**” rreth shekullit **VI** p.e.s i cili ngrihet në lartësinë shkëmbore prej 613m mbi nivelin e detit dhe si sfond midis rrënojave antike na paraqitet një peisazh mahnitës.



Në fshatin Velçë vizitorët kanë mundësinë të shohin “**Shpellën e Velçës**” e cila është një nga vendbanimet shpellore të periudhës prehistorike e zbuluar rreth viteve **1930** nga një mision arkeologjik Italian.



Shpella
Velçë



Shpella
Velçë

Një tjetër atraksion turistik që mund të vizitoni është **“Ura e Bratit”** e cila është 50 m e gjatë dhe ka një lartësi maksimale prej 12m. Kjo urë është ndërtuar në shek **XVI**.



Ura e Bratit

Atraksion i veçantë në llojin e vetë si nga punimi artistik ashtu dhe nga vlerat historike që paraqet, është **Monumenti i Drashovicës (1920-1943)**.



Tradita që është përcjellë brez pas brezi në këto zona është blegtoria dhe bujqësia. Vizitorët do të njihen gjithashtu edhe me këngët polifonike, kostumet dhe vallet tradicionale të zonës së Labërisë.





Lumi Shushicë



Kisha e 'Shën Kollit'
Armen



Këto janë vetëm disa prej shumë atraksioneve që mund të vizitoni dhe që ofron territori i **Bashkisë Selenicë**. Jeni të mirëpritur.